

# STATUTI I SHOQËRISË dhe AKTI I THEMELIMIT

## "EXCHANGE RIVOL" SHPK

Sot me datë 08/08/2022, në përputhje me:

- Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"

Z. RIVOL PERPALAJ, shtetas Shqiptar, i lindur me 26.05.1996 në Tiranë dhe banues në adresën : Rr. "Bibë Pasha"; Nd. 25; H. 1; Ap. 1; Njësia Administrative Nr.8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë; madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtes i Letërnjoftimit me nr.personal J60526060S, themelon në cilesinë e Ortakut të Vetëm, Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "EXCHANGE RIVOL" SHPK me përmbajtjen si më poshtë vijon:

### KAPITULLI

#### **FORMA; KOHEZGJATJA; ZYRA QENDRORE; OBJEKTI**

##### **Neni 1: Forma Juridike**

Shoqëria "EXCHANGE RIVOL" SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personi fizik i sipërpërmendur, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

##### **Neni 2: Kohezgjatja**

Shoqëria e fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Kohezgjatja e shoqërisë është me afat të pakufizuar që fillon prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (më poshtë referuar si QKB).

Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të pezullojë ose mbyllë veprimtarinë e saj kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.



### **Neni 3: Zyra Qendrore**

Zyra Qendrore e Shoqërise ndodhet në adresen:

Rr. "Mahmut Fortuzi", Nd. 1; Ap. 1; Tiranë.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 4: Objekti**

Shoqëria do të ketë për objekt kryesor të veprimtarisë së saj:

a) Këmbim Valutor; b) Transferim të Parave në emër dhe për llogari të institucionit financiar jo Bankë; c) Ushtrimi i veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime si agjent; ç) Ushtrim i ndërmjetësimit të pagesave utilitare; d) Ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të shërbimeve telefonike dhe celulare; dh) Shoqëria ka të drejtë të kryej shërbimet e transfertave të parave, shërbimin e pagesave, komisionerit dhe shkëmbimit të vlerave monetare ( exchange ) për llogari të saj apo të çdo subjekti financiar jobankë. e) Ushtrimi i veprimtarisë si agjent Postar. ë) Organizime paketash turistike dhe pushimesh në grup dhe individuale. Shitje biletash avioni, tragei dhe autobusi, rezervim hotelesh dhe shërbime të tjera në fushën e turizmit brenda dhe jashtë vendit.

-Gjithashtu, për të realizuar objektivat e saj, shoqëria mund të ndërmarrë e të zhvillojë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që siguron të ardhura dhe fitime të ligjshme. Objekti i shoqërisë mund të zgjerohet apo zvogëlohet në varësi të interesave të shoqërisë dhe në bazë të vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve.

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI**

#### **Neni 5: Kapitali themeltar**

5.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.500.000 lek i formuar në masë të plotë nga kontributi i ortakut dhe i ndarë në një kuotë me vlerë nominale sipas ndarjes së mëposhtme. Çdo kuotë njësie



ka te drejten e nje vote. Pjesmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij si me poshte:

Ortaku themelues, Riviol Perpalaj, zoterues i nje kuote me viere te pergjithshme 2.500.000 (Dymilion e pesëqind mijë)lekë, që përbën 100% te kapitalit themltar te shoqerise.

### KAPITULLI III

#### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

##### **Neni 6: Organet kryesore drejtuese te shoqerise jane:**

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve
- Administratori

##### **Neni 7: Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

Te drejtat dhe detyrimet

7.1 .Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi I vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

7.2. Asambleja e pergjithshme e ortakeve është pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare të shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar;
- d) percaktimin e shpërblimeve per personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "c" të kësaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarise;


- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve te asamblese;
- i) ceshtje te tjera të parashikuara nga ligji


7.3. Nëse shoqeria zotërohet nga nje ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë se pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku I vetem regjistrohen në një regjister te vendimeve, te dhënat e te cilit nuk mund td ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund ti kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirëbesim, përvec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo në baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

### **Neni 8: Mënyra e thirrjes se mbledhies se Asamblese se Pergjithshme se Ortakeve**

8.1. Asambleja e pergjithshme thirret nëpërmjet nje njoftimi me shkrese drejtuar ortakeve te shoqerise. Njoftimi me shkrese duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

8.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 10.1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregulisise.



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'Kategoria e Sigurimit', 'Kamëra e Arbitratorëve', 'Lic.Nr. 1699', and 'ALEXANDER PRELA'. The signature is a complex, stylized scribble.

### **Neni 9: Kuorumi**

- a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shumë se 30 per qind të kuotave.
- b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkresë.
- c) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur më lart, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 10: Marrja e vendimeve**


Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e ekspertëve kontabel të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve;
- d) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### **Neni 11: Administrimi**

11.1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, të cilët duhet të jenë detyrimisht ortakë të saj. Afati i emërimit të administratorit është



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text "Dhërmësi i Komititetit të Administrimit të Shoqërisë", "Lic.Nr. 1600", and "ALEKSANDËR PREKA".

5 vjet, me te drejte riperteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare e Biznesit.

11.2. Administrator i pare i shoqerise eshte Z. Riviol Perpalaj, i cili zgjidhet per nje perjudhe 5 vjecare. 11.3. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratoret ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

### **Neni 12: Kompetencat e administratoreve**

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblesë së pergjithshme per miratim;
- d) krijojne një sistem paralajmerimi në kohën e duhur per rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencën e shoqërise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhënat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet në ligjin per Qendren Kombëtare te Biznesit;
- e) raportojne perpara asamblesë së pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

### **Neni 13: Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindre midis Shoqerise dhe te treteve, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor nen juridiksionin e se ciles shtrihet aktiviteti i shoqerise.

#### **Neni 14: Largimi i ortakut**

Ky statut nuk mund te perjashtoj apo te kufizojë td drejtën e ortakut per tu larguar nga shoqeria dhe te drejtën e shoqerise per te perjashtuar ortakun ne baze te dispozitave perkatese te legjislacionit tregtar ne fuqi.

#### **Neni 15: Dispozita perfundimtare**

Në çdo rast, palet do ti referohen dispozitave ligjore te ligjit 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per zgjidhjen e ceshtjeve konkrete dhe te detajuara te cilat nuk jane permendur specifikisht ne kete akt themelimi personi juridik.

Ky statut u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi u miratua ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem i Shoqerise, u nenshkrua rregullisht nga përfaqësuesi i tij me Prokurë të posaçme ( prokura Bashkangjitur) pa asnje verejtje.

#### **Themeluesi**

**Riviol Perpalaj**

Nëpërmjet përfaqësuesit me Prokurë të posaçme

**Av. Aleksander Preka**



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Aleksander Preka'. The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'Dhjetor 2018', 'Avokatëve të Shoqërisë', 'Lic.Nr. 1699', and 'ALEKSANDER PREKA'. In the center of the stamp is a scale of justice symbol.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALBANA XH. SPAHIU  
ADRESA NR.9, HAXHI HYSEN  
DALLIU, NR.59, NR.11  
TEL: 672530602

## PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 2563

Nr. koleksioni: 935

Tirane më 04/08/2022



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022051000097970933

\*Akti noterial përbëhet nga 1 fletë





## PROKURË E POSAÇME

Sot, më datë 04 Gusht 2022, para meje Notere ALBANA XH. SPAHIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, HAXHI HYSEN DALLIU, NR.59, NR.11, u paraqit personalisht:

### I PËRFAQËSUARI:

**Z. RIVOLI PERPALAJ**, atësia Petrit, amësia Violeta, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Bibë Pasha; Nd. 25; H. 1; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 26/05/1996, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031852578 dhe nr. personal J60526060S.

I cili ka kerkuar hartimin e kësaj Prokure të Posacme:

"Emëroj si përfaqësues të posaçëm Av. Aleksander Preka, Anetar i Dhomes se Avokateve Shkoder, me nr. License 1699 NIPT L81619005N, dhe/ose Av. Gezim Pjetraj, me nr. License 8752, Dhoma e Avokatise Tirane, të cilëve u jap të drejta dhe kopmetenca të plota që, në prani ose në mungesën time, të dy së bashku apo veç e veç, të më përfaqësojnë pranë te gjitha institucioneve publike perkatase ne lidhje me pergatitjen e dokumentacionit te nevojshem, paraqitjen e ketij dokumentacioni prane QKB (Qendra Kombetare e Bizneseve), QKL (Qendra Kombetare e Licensimeve), Bankes se Shqiperise, etj., per pajisjen time me Licensen per Ushtrimin e Aktivitetit te Kembimit Valutor, etj. Perfaqesuesit kane te drejten te hartojne, neshkruajne dhe paraqesin Kerkesen apo kerkesat, te kerkoje dhe marre dokumentacion, te kerkoje vertetimet perkatase apo dokumentacion te nevojshem prane Prokurori dhe Gjykate kompetente, Gjendje Civile etj. Kane te drejte te kryejne pagesat perkatase. Njoftimet të merren nga Avokatet. Të gjitha veprimet që do të kryhen nga Avokatët, i njoh sikur f.i kemi kryer vetë. Efektet e kësaj Prokure të Posaçme do të fillojnë nga data e nënshkrimit të saj dhe është pa afat.

Ajo mbaron për shkaqet e parashikuara ne nenin Kodit Penal dhe nenin 76 te Kodit Civil apo me revokimin e saj nga ana ime.

*Une porositësi deklaroj se, pas nenshkrimit të kësaj Prokure, njoh dhe miratoj të gjitha veprimet e Avokateve, që do t'i quaj si të ligjshme, të rregullta, të vlefshme dhe të pa cënueshme, sikur të ishin kryer nga unë vetë, me kusht që ato të jenë realizuar në përputhje me porositë e dhëna dhe ligjet në fuqi.*

Prokuara e Posacme realizohet në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenin 48 te Kodit Penal dhe nenin 70 e vijues, 75, 76 e vijues të Kodit Civil, në fuqi, si dhe nenit 62 pika 1 germa "ll" ë Ligjit Nr.110 datë 18.12.2018 "Për NOTERINE". Prokura përpilohet në pesë kopje të njëjta, ju lexua me zë të përfaqësuarave, kuptohet prej tyre, dhe pasi u gjet në rregull sipas vullnetit të tyre të lirë e të plotë, nënshkruhet rregullisht prej tij para meje Noteres, sipas ligjit. Unë noterja vërtetoj në bazë të legjislacionit civil në fuqi dhe Ligjit nr.7829 datë 01.06.1994 "Për Noterinë", i ndryshuar.

I përfaqësuari deklaroi se ka dhënë pëlqimin e tij, në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", pra për trajtimin e tyre nga unë noterja. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Taksa e pulles 200 Leke mbahet ne kopjen e Arkives Noteriale.

### I PËRFAQËSUARI

*Rivoli Perpalaj*

NOTERE  
ALBANA XH. SPAHIU



*Albana Xh. Spahi*

Fq. 1